

KËSHILLI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 5 date 13.03.2009

Per ndryshimin e Statusit dhe emërimit të Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi" dhe vlerësimin për Programin e Studimit të Ciklit të Parë, Diplomë e Nivelit të Parë në Fushat e Aktivitetit Fizik dhe Rekreacionit.

Këshilli i Akreditimit, pasi shqyrtoi relacionin "Për strukturën aktuale institucionale të Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve (AEFS) dhe propozimin për strukturën e re të emërtuar, Universiteti Shqiptar i Sportit (USHS) si edhe propozimin për Programin e ri të studimit, Diplomë e Nivelit të Parë në **Fushat e Aktivitetit Fizik dhe Rekreacionit**, bazuar në raportin e vlerësimit të ekspertëve dhe në raportimin e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë për procedurën e vlerësimit dhe respektimin e kriterëve, bazuar në standardet shtetërore të cilësisë, arrin në këto përfundime:

- Struktura e re e kërkuar, Universiteti Shqiptar i Sportit i përmbush standardet përkatëse institucionale dhe **jep vlerësim pozitiv.**
- Përmbajtja e Programit të Ri të Studimit, Diplomë e Nivelit të Parë në Fushat e Aktivitetit Fizik dhe Rekreacionit, përmbush standardet e cilësisë dhe **jep vlerësim pozitiv.**

Këshilli i Akreditimit, bazuar në kompetencën që i jep Ligji Nr 9741, date 21.5.2007, Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, VKM Nr. 303, date 1.7.1999, Për Krijimin e Sistemit të Akreditimit në Arsimin e Lartë, i rekomandon Ministrin të Arsimit dhe të Shkencës:

Institucioni:

Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi" të ndryshojë emërtimin në **UNIVERSITETI SHQIPTAR I SPORTIT.**

Programi i studimit: Diplomë e Nivelit të Parë në Fushat e Aktivitetit Fizik dhe Rekreacionit, **të hapet.**

KËSHILLI I AKREDITIMIT

Bardhyl MUSAI	Kryetar
Gëzim HADAJ	Anëtar
Emil LAMANI	Anëtar
Anila RODA	Anëtar
Vladimir NIKA	Anëtar
Shyqyri LLACI	Anëtar
Illir BOZGO	Anëtar
Qamil DIKA	Anëtar